



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më ___/ ___/ 2021

VENDIM

Nr.25, date 28 /06/2021

PËR

PROJEKTIN E ZBATIMIT ME OBJEKT "REHABILITIM I MEKANIZMIT TE KOMANDIMIT TE PORTAVE TE UJELESHUESIT DHE SHKARKUESIT ANESOR TE DIGES PEZE GJYSLIKONE"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" si dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në mbledhjen e datës 28.06.2021 mori në shqyrtim Projektin e zbatimit për Rehabilitimin e Mekanizmit të komandimit të portave të Ujeleshuesit dhe shkarkuesit katastrofik anesor të diges Peze Gjyslikone.

Bazuar në dokumentacionin teknik të paraqitur nga Bashkia Tirane si shfrytëzues i kësaj dige, kushtet aktuale të diges, si dhe kërkesave të legjislacionit të mesiperm, KKDM,

VENDOSI:

- 1- Të Mos Miratojë Projektin e Zbatimit të paraqitur nga Bashkia Tirane për "Rehabilitimin e Mekanizmit të komandimit të portave të Ujeleshuesit dhe shkarkuesit katastrofik anesor të diges Peze Gjyslikone" për arsye të mosplotësimit të kërkesave të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Nenit 9,10 dhe 13
- 2- Ti kërkoj Bashkisë Tirane si shfrytëzues i digës dhe nënobjekteve të saj:
 - Rishikimin e Projektit të zbatimit dhe Detyres së projektimit për Rehabilitimin e kësaj dige në funksion të situatës aktuale të diges dhe të volumit të ujit në rezervuarin e krijuar prej saj për arsye të rreshqitjes në bieftin e poshtëm të saj e konstatuar gjatë kontrollit në terren të KKDM, mbushjeve me sedimente të rezervuarit dhe zvogelimit të volumit të ujit në të cilin nuk është matur që prej 40 vitesh.
 - Marrjen e masave për një monitorim të vazhdueshëm të gjendjes dhe sigurisë së diges si dhe hartimin e planit të gadishmerisë në rastet e emergjencave civile të kërkuar nga legjislacioni në fuqi.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për zbatimin e këtij Vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

